



Instituti për Bashkitë Shqiptare
'për qytete të qëndrueshme'

Terma reference

Ekspertizë lokale për ngritjen e kapaciteteve të Këshillit Rinor të bashkisë Kavajë
Projekti “E ardhmja e Bashkisë - ndërtuar mbi rini të fortë”

Autoritet kontraktues: Instituti për Bashkitë e Shqipërisë
Rr. “Skerdilajd Llagami”, Ndr. 3/9, Tiranë
M31318452D

Data e publikimit: 21 mars 2025

Instituti për Bashkitë e Shqipërisë është një organizatë e shoqërisë civile, me interes të kontribuojë për progresin dhe zhvillimet lokale, rajonale dhe kombëtare, për një qeverisje të mirë dhe decentralizim përmes asistencës, kërkimeve, studimeve dhe trajnimeve profesionale, duke përdorur vetëm mjete dhe rrugë ligjore dhe demokratike.

IBSh ka nisur zbatimin e Projektit “E ardhmja e Bashkisë - ndërtuar mbi rini të fortë”, mbështetur nga bashkia Kavajë si pjesë e Programit ReLOaD2. Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2) është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga PNUD në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.

Në zbatim të këtij projekti, Instituti për Bashkitë publikon këtë njoftim për subjektet e interesuara për shërbimet e ekspertizës lokale të detajuara më poshtë.

1. Objektivi i ekspertizës

Objektivi i kësaj ekspertize lokale është ngritja e kapaciteteve të Këshillit Rinor të bashkisë Kavajë përmes një trajnimi një ditor mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore dhe administratës publike .

2. Metodologjia

Eksperti lokal do të punojë së bashku me stafin e Institutit për Bashkitë dhe anëtarët e Këshillit Rinor për përgatitjen e kësaj detyre. Ekspertiza do të ofrohet si kombinim i punës kërkimore, takime online dhe takime fizike, konsultimit dhe prezantimit të draft dokumentit.



Instituti për Bashkitë Shqiptare
'për qytete të qëndrueshme'

3. Detyrat specifike të ekspertit lokal

Detyrat specifike në mbështetje të Këshillit Rinor përfshijnë:

- 3.1 Prgatitja e strukturës së Trajnimit mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor dhe administratës publike në përgjithësi. Trajnimi duhet të përfshijë çështje të legjislacionit përkatës, organizimi administrativ i bashkive, të ardhurat, marrëdhënia me qeverinë qendrore si dhe organizimi i administratës publike në nivel qendror. Struktura e trajnimit do të miratohet paraprakisht dhe më pas do të zhvillohet si material trajnimi.
- 3.2 Ofrimi i trajnimit një ditë në bazë të kurikulës së përgatitur në bashkinë Kavajë. Trajnimi duhet të mundësojë bashkëveprimin dhe angazhimin e pjesëmarrësve duke parashikuar kohë për diskutime. Eksperti është përgjegjës për përgatitjen e axhendës.

4. Materiale për tu dorëzuar

Eksperti duhet të përgatisë dhe dorëzojë materialet e mëposhtme:

- 4.1 Kurrikulën e Trajnimit mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor dhe qendror
- 4.2 Prezantim ppt për Trajnimin
- 4.3 Axhendën e Trajnimit
- 4.4 Raport mbi trajnimin e zhvilluar

5. Afati

Ekspertiza duhet të ofrohet për 4 ditë pune gjatë muajit mars 2025. Data specifike e organizimit të trajnimit do të njoftohet 5 ditë kalendrike paraprakisht.

6. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë teknike dhe ekonomike. Kriteret teknike kanë 70% të pikëve të vlerësimit dhe kriteri ekonomik ka 30% të pikëve.

Subjektet e interesuara duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme teknike:

- 6.1 Të kenë mbaruar studimet e larta universitare në fusha si kuridik, shkenca sociale, administrim publik etj.
- 6.2 Të kenë eksperiencë të mëparshme në fushuën e qeverisjes vendore. Puna më Këshillat Rinor do të përbëjë avantazh.
- 6.3 Të ketë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e trajnimeve dhe në përgatitjen e dokumentave udhëzuese.



Instituti për Bashkitë Shqiptare
'për qytete të qëndrueshme'

Kriteri ekonomik është respektimi i buxhetit maksimal të aktiviteteve sipas këtij njoftimi.

7. Buxheti

Buxheti maksimal për këtë ofertë është 88,000 lekë bruto. Pagesat do të kryhen të ndara sipas aktiviteteve përmes transfertave bankare deri në 5 ditë kalendarike pas aktivitetit. IBSH do të mbajë nga kjo pagesë 15% për tatimin në burim në rastin e personave që nuk janë të pajisur me NIPT. Pagesat me lekë në dorë nuk janë të lejuara.

8. Aplikimi

Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 8.1 CV të azhornuar në gjuhën shqipe
- 8.2 Kopje të Kartës ID
- 8.3 Ofertën ekonomike përfshirë tatimin në burim.

Aplikimet duhet të dërgohen online në adresat e emailit info@iam.org.al dhe info@bashkiakavaje.gov.al, titulli i emailit duhet të jetë **Ekspertizë lokale për ngritjen e kapaciteteve të Këshillit Rinor të bashkisë Kavajë**. Afati për dorëzimin e aplikimeve është 7 ditë kalendarike pas publikimit të njoftimit, **data 28 mars 2025**.